



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 19 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 29/04/2021

VENDIM
Nr.19, date 29 /04/2021

PËR

**RAPORTIN VJETOR TE SHFRYTEZIMIT TE DIGAVE TE ADMINISTRUARA NGA
MINISTRIA E BUJQËSISE DHE E ZHVILLIMIT RURAL**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" Neni 32, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 29/04/2021 mori në shqyrtim Raportin Vjetor të shfrytëzimit të digave të administruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). Bazuar në Raportin e paraqitur, gjëndjen aktuale të digave përkatëse dhe kërkesave të legjislacionit të mësipërm, KKDM

VENDOSI:

1- Ti kërkojë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

- Plotësimin e dosjeve teknike për 8 digat e shfrytëzuara nga MBZHR
- Instalimin e Sistemeve të Monitorimit të digave dhe Sistemeve të Alarmit sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në 8 digat e shfrytëzuara nga MBZHR
- Dorëzimin e Projekteve të punimeve të kryera sipas faktit për digat që janë rehabilituar gjatë 10 viteve të fundit.
- Përgatitjen e Planeve të Gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe hartat e përmbajtjeve në pjesën e poshtme të digave sipas legjislacionit të mësipërm dhe Udhëzimeve të KKDM për të 8 digat e shfrytëzuara nga MBZHR brenda muajit Nendor 2021.
- Kryerjen e matjeve të depozitimeve të materialeve të ngurta në rezervuarët e digave të shfrytëzuara nga MBZHR (Matjet batimetrike të vëllimeve të rezervuarëve) sipas kërkesave të VKM Nr.147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", neni 30

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në përputhje me këtë Vendim dhe legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

